VENDIM
Nr. 27, datë 9.5.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 11.3.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Avokatura e Përgjithshme e Shtetit

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Media +” sh.a., Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr. 2819, datë 22.12.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2012-2659, datë 21.12.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/1/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Shoqëria “Media +” sh.a. (TV Shijak), person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ushtruar aktivitetin privat në fushën e transmetimeve televizive, në bazë të licencës të lëshuar në vitin 2000, për këtë qëllim, nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (në vijim: KKRT).

2. Me vendimin nr. 298, datë 22.12.2004, KKRT-ja ka bërë të pavlefshme licencën e sipërcituar dhe ka vendosur që ky televizion të ndërpresë menjëherë transmetimet. Në bazë të këtij vendimi ka dalë urdhri nr. 2, datë 10.1.2005 i KKRT-së “Për mbylljen e aktivitetit transmetues të TV Shijak”, i cili është ekzekutuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duke bërë bllokimin e kabllove dhe pajisjeve transmetuese.

3. Me vendimin nr. 1732, datë 30.3.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së shoqërisë “Media +” sh.a., duke ndryshuar vendimin nr. 298/2004 të KKRT-së për sa i përket sanksionit administrativ dhe duke vendosur masën e uljes së afatit të licencës deri në 50% të saj. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 217, datë 15.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Në zbatim të vendimit gjyqësor, KKRT-ja, me vendimin nr. 451, datë 27.4.2006, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të saj nr. 298/2004.

5. Në vitin 2006, shoqëria “Media +” sha ka depozituar pranë KKRT-së kërkesë për shpërblimin e dëmit, e cila është rrëzuar me vendimin nr. 565, datë 29.1.2007.

6. Me vendimin nr. 698, datë 16.7.2008, KKRT-ja ka vendosur rinovimin e licencës së subjektit televiziv “TV Shijak” (shoqëria “Media +” sh.a.), për një afat të ri 5-vjeçar, vendim i cili i shtrin efektet që nga data 3.1.2006.

7. Shoqëria “Media +” sh.a. i është drejtuar me padi gjykatës, me objekt detyrimin e KKRT-së për shpërblimin e dëmit në vlerën 143.603.288 lekë.

8. Me vendimin nr. 10709, datë 21.12.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pabazuar.

9. Me vendimin nr. 2819, datë 22.12.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit civil nr. 10709, datë 21.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë: Pranimin pjesërisht të padisë së palës paditëse shoqërisë “Media +” sh.a. (TV Shijak), duke detyruar palën e paditur KKRT në Republikën e Shqipërisë, për shumën 112.861.320 lekë dhe rrëzimin për pjesën tjetër në shumën 30.741.908 lekë...*”. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs Avokatura e Shtetit.

10. Me vendimin nr. 00-2012-2659, datë 21.12.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

11. ***Kërkuesi, Avokatura e Shtetit***, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Lartë, për këto shkaqe:

11.1 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është haptazi jologjik dhe kontradiktor, duke i sjellë një dëm të rëndë buxhetit të shtetit. Kjo gjykatë, edhe pse arsyeton se licenca e shoqërisë “Media +” sh.a. skadonte në datën 3.1.2006, më tej shprehet se periudha për të cilën duhet të dëmshpërblehet ky subjekt fillon në datën 28.12.2004 dhe mbaron në datën 16.7.2008, pra për një periudhë për të cilën konstatohet nga

vetë gjykata se licenca kishte skaduar.

11.2 Është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi dy nga anëtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që kanë shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi, konkretisht gjyqtarët F.L. dhe A.Z., kanë qenë më parë anëtarë të KKRT-së, dhe pjesë e vendimmarrjes së këtij organi në lidhje me shoqërinë "Media +" sh.a. Më konkretisht, gjyqtari F.L. ka marrë pjesë në marrjen e vendimit nr. 298/2004 të KKRT-së, kurse gjyqtari A.Z. në marrjen e vendimit nr. 698/2008 të KKRT-së, për rinovimin e licencës këtij subjekti.

12. ***Subjekti i interesuar, Shoqëria "MEDIA +" sh.a.***, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka parashtruar:

12.1 Pretendimi i kërkuesit lidhur me kontradiktën dhe mungesën e logjikës në përmbajtjen e vendimit nuk është ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ndaj në lidhje me këtë pretendim ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion.

12.2 Shoqëria "Media +" sh.a. është licencuar për transmetime televizive vendore për periudhën 3.1.2001 deri 3.1.2006, licencë që është hequr padrejtësisht me vendimin e KKRT-së të datës 22.12.2004, por që është konsideruar e paligjshme nga gjykata. Gjendja e paligjshmërisë së heqjes së licencës ka filluar në 22.12.2004 dhe ka vijuar deri në datën 16.7.2008, datë në të cilën ajo është rinovuar dhe është pikërisht kjo periudhë për të cilën gjykata ka pranuar ekzistencën e dëmit. Në këto fakte të pranuara nga gjykata nuk ka asnjë kontradiktë dhe mungesë logjike, pasi periudha e pranimit të paligjshmërisë së heqjes së licencës dhe llogaritjes së dëmit janë në koherencë me njëra-tjetrën dhe faktet janë shqyrtuar bazuar në dispozitat e Kodit Civil që lidhen me shkaktimin e dëmit.

12.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, procesi që është objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese ka filluar me vendimin nr. 565, datë 29.1.2007 të KKRT-së, për shqyrtimin e kërkesës së subjektit të interesuar për shpërblimin e dëmit. Në këtë vendim gjyqtarët F.L. dhe A.Z. nuk kanë qenë në marrëdhënie pune me palën e paditur dhe as kanë marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj kërkese.

12.4 Vendimet e KKRT-së nr. 298/2004, në të cilin ka marrë pjesë gjyqtari F.L., dhe nr. 698/2008, në të cilin ka marrë pjesë gjyqtari A.Z., janë paraqitur si prova në gjykim dhe kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me to. Ato nuk kanë qenë objekt kundërshtimi në rekurs dhe nuk janë bërë objekt diskutimi as në dhomën e këshillimit. Gjykata e Lartë nuk ka në kompetencë të saj vlerësimin e provave të marra gjatë gjykimit në fakt, por i ushtron funksionet në kuptim të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Të dy këta gjyqtarë, në kohën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë nuk kanë pasur asnjë nga ato cilësi që përcakton neni 72/5 i KPC-së. Po ashtu, referimet që kërkuesi bën në vendimet e GJEDNJ-së apo të Gjykatës Kushtetuese nuk janë të zbatueshme në rastin në shqyrtim.

13. ***Autoriteti i Mediave Audiovizive***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës është shprehur se:

13.1 Vendimi i gjykatës së apelit, i cili ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, është marrë në kundërshtim me ligjin, është i pabazuar në prova dhe fakte, si dhe rrjedhojë e një gjykimi të njëanshëm. Gjykata e apelit nuk ka qenë para asnjërit nga rastet e parashikuara nga KPC-ja për prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe pranimit të padisë. Riçelja e hetimit gjyqësor nga ana e asaj gjykate ishte e pavend, e pabazuar në ligj, prova e rrethana.

13.2 Gjykata e apelit ka konsumuar shkelje të rënda procedurale. Në kuptim të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, shoqëria "Media +" sh.a. vlerësohet e prishur dhe çdo kërkim në emër të saj nuk mund të legjitimohet. Pas riçeljes së hetimit gjyqësor, në gjykatën e apelit u shtua fusha e kërkimit për shpërblimin e dëmit të pretenduar dhe shtrirja e tij në kohë. Gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh faktin se veprimtaria e shoqërisë "Media +" sh.a. ka qenë në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi. Ajo akordoi masën e dëmshpërblimit pa marrë parasysh ekspertizën e ekspertëve kontabël të thirrur prej saj.

13.3 Dy nga anëtarët e Kolegjit Civil, që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Avokati i Shtetit, kanë qenë në cilësinë e anëtarit të KKRT-së, në marrjen e vendimeve nr. 298/2004 dhe nr. 698/2008 të KKRT-së, që kanë të bëjnë me subjektin e interesuar TV Shijak (shoqëria "Media +" sh.a.).

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimimin e kërkuesit

14. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vlerësuar se, në respekt të rregullimeve të parashikuara nga nenet 16, 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "g" të Kushtetutës, legjitimimi i subjektit për t'iu drejtuar kësaj gjykate nuk kushtëzohet nga karakteri i tij si person juridik, publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që ai parashtron (*shih vendimin nr. 42, datë 29.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në bazë të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", ky subjekt ka të drejtën e nisjes së veprimeve ligjore me qëllim për të shfuqizuar akte juridike dhe kontrata administrative, si dhe për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në pajtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural dhe në atë ligj. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave publike nga ana e Avokaturës së Shtetit, në një gjykim të filluar, është një përfaqësim dhe mbrojtje e detyrueshme dhe gjykatat, sipas nenit 79/a të KPC-së, kanë detyrimin që t'i njoftojnë aktet Avokaturës së Shtetit me qëllim që kjo e fundit jo vetëm të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim, por edhe të realizojë mbrojtjen e interesave të shtetit (*shih vendimin nr. 27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky qëndrim gjen mbështetje edhe në vendimin unifikues nr. 13, datë 24.3.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që i referohet nenit 1 të ligjit nr. 8551, datë 17.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", aktualisht i ndryshuar.

16. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se edhe në rastin konkret ky subjekt, duke qenë se ka si funksion të tij mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit, legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë

17. Kërkuesi pretendon cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për arsye se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë kanë marrë pjesë në trupin gjykues dy gjyqtarë, të cilët më parë, në ushtrimin e funksionit të anëtarit të KKRT-së, kanë marrë pjesë në vendimmarrje që lidhen me subjektin e interesuar, shoqëria "Media +" sh.a. (TV Shijak).

18. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 38, datë 15.10.2007; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste: testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (*shih vendimet nr.* 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 2.4.2009; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se edhe në rastin në shqyrtim paanshmëria duhet të vlerësohet në aspektin subjektiv dhe në atë objektiv. Për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve F.L. dhe A.Z., pra bindjes së brendshme të tyre për mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim, ndaj ajo prezumohet. Për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuesi është mjaftueshmërisht i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete.

21. Gjykata ka theksuar se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (shih vendimet nr. 12, datë 13.4.2007; nr. 15, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij, por ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel (*shih vendimet nr. 16, datë 19.4.2013; nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Në rastin konkret, kërkuesi e mbështet pretendimin për paanshmërinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në faktin se ata, në ushtrim të funksionit të anëtarit të KKRT-së, kanë qenë edhe pjesë e vendimmarrjes së atij institucioni, që i referohet konkretisht subjektit të interesuar. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se gjyqtari F.L. ka qenë anëtar i KKRT-së në kohën kur është marrë vendimi nr. 298/2004, me të cilin i është hequr licenca subjektit TV Shijak (shoqëria "Media +" sh.a.), ndërsa gjyqtari A.Z. ka qenë anëtar i KKRT-së në kohën kur është marrë vendimi nr. 698/2008, me të cilin këtij subjekti i është rinovuar licenca për një afat të ri 5-vjeçar. Nga këto dy vendime të KKRT-së rezulton se në vendimin nr. 298/2004 janë bërë vlerësime vetëm lidhur me faktin se subjekti i interesuar nuk ka paguar këstet e pagesës vjetore të licencës, si edhe se ka transmetuar programe pirate, të paligjshme, të cilat janë bërë shkak për heqjen e licencës së transmetimit, kurse në vendimin nr. 698/2008 KKRT-ja është shprehur vetëm për rinovimin e licencës, pa bërë asnjë vlerësim lidhur me veprimtarinë e subjektit TV Shijak (shoqëria "Media +" sh.a.). Për sa i përket vlerësimit që kryhet nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se në këtë fazë të procesit verifikohet legjitimiteti i rekursuesit, si dhe prania e kritereve ligjore për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, pra ai nuk është një shqyrtim në themel i shkaqeve të rekursit, çka është atribut i seancës gjyqësore.

23. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se qëllimi dhe natyra e veprimeve që dy anëtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kanë kryer gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të KKRT-së, nuk janë të tilla që të venë në dyshim paanshmërinë e tyre. Ata nuk rezulton që të kenë manifestuar më parë bindjen e tyre, brenda të njëjtit procedim, apo që në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të jenë shprehur mbi të njëjtat çështje, të cilat janë bërë më parë objekt i shqyrtimit nga KKRT-ja, gjatë kohës që ata kanë ushtruar detyrën e anëtarit të këtij organi. Për pasojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme, është i pabazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesi pretendon është cenuar në të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, pasi vendimi i gjykatës së apelit është jologjik dhe kontradiktor. Sipas tij, gjykata e apelit, edhe pse arsyeton se licenca e shoqërisë "Media +" sh.a. skadonte në datën 3.1.2006, më tej shprehet se periudha për të cilën duhet të dëmshpërblehet ky subjekt fillon në datën 28.12.2004 dhe mbaron në datën 16.7.2008, pra për një periudhë për të cilën konstatohet nga vetë gjykata se licenca kishte skaduar.

25. Gjykata, gjatë votimit të çështjes për këtë pretendim, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të barabartë[1], nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendosi refuzimin e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "g" dhe 133, pika 2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

Refuzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha,

[1] Votuan për pranimin gjyqtarët: B. Dedja, S. Berberi dhe A. Xhoxhaj. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: V.Kristo, V. Tusha dhe F. Hoxha.